

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.A "DINAMO"
TIRANE



VENDIM Nr.2
I
KESHILLIT MBIKQYRES

Keshilli Mbikqyres ne mbledhjen e tij te dates 07.12.1999 sipas rendit te dites

KONSTATON :

1. Ne mbledhjen e Jashtezakoneshme te asambles se aksionereve te sh.a "Dinamo", te dates 07.12.1999 eshte vendosur qe antare te keshillit Mbikqyres te jene :

- znj. Ermira Xhafa
- z. Dilaver Rexhepi
- Z. Gjergji Kosta

2. Ne baze te statutit eshte ne kopetence e Keshillit Mbikqyres emrimi i Drejtorit te Pergjithshem te Sh.A

Ne perputhje me statutin dhe ligjin "Per shoqerite tregetare", keshilli mbikqyres

VENDOSI

1. Drejtor i Pergjithshem i Sh.A "DINAMO" te jete
z. Rolan HYSA

2. z. **Ditbardh Pelinku** largohet nga detyra e Drejtorit te Pergjithshem te Shoqerise Sh.A. "DINAMO" dhe emerohet ne detyren e Drejtorit te Uzines.

3 Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KESHILLI MBIKQYRES

KRYETARI
DILAVËR REXHEPI

ANTAR
ERMIRA XHAFI

ANTAR
GJERGJI KOSTA

REPUBLIKA E SHQIPERISE



SH.A "DINAMO"

V E N D I M

I KESHILIT MBIKQYRES

I mbedhur sote me dt. 25.05.2002 me rend dite :-

1. Marrjen ne shqyrtim te kerkeses per dorheqje te pa revokusheme te Drejtorit te Pergjithshem z. Roland Hysa ,

2. Miratimi z. Theodhor Kristuli si kandidature per emrimin ne detyren e Drejtorit te pergjithshem te sh.a "Dinamo",
Keshilli Mbikqyrese pasi eshte njohur me materialet

K O N S T A T O N

1.Drejtori i Pergjithshem Z.Roland Hysa per arsye shendetesore ka paraqitur me shkrim kerkes per dorheqje te pa revokushme.

2. Z.Roland Hysa ka paraqitur si kandidatur per zvedesimin e tij me kandidaturen e z. Theodhor Kristuli aktualisht i punesuar ne shoqeri si pergjegjes i sektorit ekonomik.

Versimi i punes per Z.Theodhori Krituli per kete kohe qe eshte i punesuar ne shoqeri eshte i mire .

3. Z. Theodhor Kristuli ka paraqitur kerkes me shkrim per te qene si kandidatur per t'u emrim ne detyren e Drejtorit te Pergjithshem .

Ne kerkes parashtron :-

- Ka mbaruar fakultetin Ekonomik ne vitin 1986 ,

- Eshte i martuar me nje femije,

- Ka eksperience pune ne drejtimi dhe menezhim pasi ka kryer detyra te dryshme si ekonomist ne ndermarrje te vogela dhe te medha, ka qene specialist ne Ministrine Bujqesise dhe Ushqimit, si dhe ka drejtuar biznese te tjera private .

Ne perfundim Keshilli Mbikqyrese

V E N D O S I

1.Te liroje nga detyra e Drejtorit te Pergjithshem z. z. Roland Hysa me kerkesen e tije .

2. Te emroje ne detyren e Drjtorit te Pergjithshem z. Theodhor Kristuli.

3. Te drejttat ekonomike z. Roland Hysa te shkeputen me dt. 01.03.2002

4. Te drejttat ekonomike per z. Theodhor Kristuli te fillojne nga data 01.03.2002.

- .Autorizohet Drejtori i Pergjithshem z. Theodhor Krituli te nxjerre urdhrat perketase per ekzekutimin e ketije vendimi.

- Si dhe te beje depozitimn e ketije vendimi ne rregjistrin tregtar te Gjykates se Tiranes.

Ky vendim hyn ne fuqi menjhere.

KESHILLI MBIKQYRES

KRYETARI

DILAVER REXHEPI

ANTAR

ERMIRA XHAFI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA

Nr. 202 rep.

Nr. 2 kol



ANTAR

ROZAFAT SHLLAKU



VERTETIM

Sot me dt. 30.05. 2002(dymije e dy) para meje noterit Ylli Mahmuda me zyre ne adrese: " Rruga Punctoret e Rilindjes" u paraqiten personalisht, **Dilaver Rexhpaj**, znj. Ermira Xhafa, dhe Rozafat Shllaku te njohur personalisht prej meje ,banues ne Tirane madhor me zotesi te plote procedurjale per te vepruar ,te cilet deklarojne se vendimi Keshillit Mbiqyres eshte perputhje me vullnetin e tyre dhe e nenshkruan rregullisht dhe une noter i publik e vertetoj ne baze te ligjit nenshkrimin e tyre .

NOTERI

Ylli MAHMUDA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

SH.A "DINAMO"



V E N D I M

I

KESHILLIT MBIKQYRES

Imbedhur sote me dt 18/08/2009, me rend dite :-

1. Shqyrtimin e kerkeses per dorheqje te pa revokushme te Drejtorit te Pergjithshem Theodhor Kristuli
2. Shqyrtim kerkeshash per emrimin e Drejtorit te Pergjithshem
3. Te ndryshme

Keshilli Mbikqyres pasi eshte njohur me materialet

K O N S T A T O N

- 1.Z. Theodhor Kristuli ka paraqitur kerkese per dorheqje te pa revokushme nga detyra e Drejtorit te pergjithshem .
2. Aksioneri z. Roland Hysa zotrues i paketes kontrolluse ka propozuar qe ne vend te z. Theodhor Kristuli Drejtor i Pergjithshem te emrohet z.Vasil Meci i biri i Jaupit ,i datlindjes 20/12/1945 ,banues ne Tirane

Ne perfundim Keshilli Mbikqyrese

V E N D O S I

- 1.Te pranoje kerkesen e Z.Theodhor Kristuli per dorheqje te pa revokushme nga detyra e Drejtorit te pergjithshem te sha "Dinamo "

- 2 Te emrojme ne detyren e Drejtorit te Pergjithshem te sha "Dinamo" z. Vasil Jaup Meci
3. Te drejtat finacjare per Z. Theodhor Kristuli nderpriten me dt. 30/08/2009
4. Te drejtat finacjare per Drejtorin ZVasil Meci fillojne nga data 01.09.2009
5. Urdherohet zyra e finances per ekzekutimin e ketije vendimi
6. Autorizohet Drejtori i Pergjithshem Z Vasil Jaup Meci te beje depozitimin e ketije vendimi ne QKR
Ky vendim hyn ne fuqi menjhere.

KESHILLI MBIKQYRES

KRYETARI

Av.DILAVER REXHEPAJ

ANTAR

ERMIRA XHAFA

ANTAR

ZHEVDET MEHMETI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
NR 5558 REP NR 813 KOI.

VERTETIM NENSHIKRIMI

Ne Tirane, sot me date 05/10/2009(Dymije nente) para meje noter Halil Sinani me seli ne Rrugen "George W Bush" u paraqiten personalisht palet e meposhteme :

1. Dilaver Rexhepaj i biri i Cercizit i datelindjes 14-01-1950,banues ne Tirane madhore me zotesi te plote juridike e per te vepruar , i njohur prej meje noterit .
2. Ermira Hysa (Xhafa) e bija e Luanit e datelindjes 07.12.1971,banues ne Tirane , madhore me zotesi te plote juridike e per te vepruar , nga pashaporta nr. S 0002947.
3. Zhevdet Mehmeti i biri i Abdullait i datelindjes 29.06.1955 ,banues ne Tirane madhore me zotesi te plote juridike e per te vepruar , i njohur prej meje noterit .

Te cilet deklaruan se sa me siper se kane redaktuar kete Vendimin e Keshillit Mbikqyres date 18/08/2009, me vullnetin e tyre te lire e nenshkruajne rregullisht para meje dhe une Noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTER
HALIL SINANI



"DINAMO" SH.A.

Adresa: Rr. "Ferit Xhajko", Tiranë - ALBANIA

Tel/Fax: +355 4 225 619 / 271 777 / e-mail: mekanika@dinamo-sha.com / www.dinamo-sha.com

Tirane me 31.08.2012

Vendim i Keshillit Mbikqyres te Shoqerise

"DINAMO" sha

N. 45

Sot me dt. 31.08.2012 u mbledh Keshilli Mbikqyres i shoqerise "DINAMO"sha i cili ne mbledhjen e radhes mori ne shqyrtim rendin e dites si me poshte:

1. Emerimin e Administratorit te ri te Shoqerise
2. Domosdoshmeria e kreditimit te shoqerise per te perballuar investimet e reja ne aktive te Shoqerise.
3. Te ndryshme

Keshilli Mbikqyres pasi shqyrtoi materialet e pergatitura sipas rendit te dites, pas diskutimesh te shumta

VENDOSI

1. Te miratoj kandidaturen e Z. Nexhip MEÇI si Administrator i Shoqerise "DINAMO" sha
2. Te çelet nje linje kreditimi prane bankave te nivelit te dyte deri ne shumen 15 000 000 leke.
3. Te behen ndryshimet ne QKR lidhur me emerimin e Administratorit te Ri te Shoqerise.

Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Administratori i Shoqerise "DINAMO" sha

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

Keshilli Mbikqyres

Kryetari Dilaver REXHEPAJ

Anetare Shpresa BREÇAN

Anetar Xhevdet MEHMETAJ

VENDIM I KESHILLIT MBIKQYRES
DINAMO SH.A .
NR. 54

I mbledhur sot , më datë 31.05.2016, Këshilli Mbikqyrës i ``Dinamo`` Sha, mori ne shqyrtim rendin e dites si vijon :

1. Shqyrtimin e doreheqjes nga detyra e Administratorit te Shoqerise z.Nexhip Meci.
2. Emerimin e Administratorit te ri te Shoqerise.

Keshilli Mbikqyres, pas diskutimeve lidhur me pikat e parashikuara ne rendin e dites,

VENDOSI :

- 1-Te miratoje doreheqjen e z. Nexhip Meci nga detyra e administratorit te Shoqerise ``Dinamo``Sha.
- 2-Te emeroje ne detyren e Administratorit te kesaj Shoqerie per nje periudhe 3-vjecare zj. Migena Rec, duke filluar nga data 01/06/2016 .
- 3-Te behet depozitimi i ketij Vendimi ne QKR brenda afateve ligjore.
- 4-Per zbatimin e kesaj detyre ngarkohet zj. Migena Rec.

Kryetari Keshillit Mbikqyres

Dilaver Rexhepaj

Anetar

Theodhor Kristuli



Anetar

Gjergj Kosta





"DINAMO" SH.A.

Adresa: Rr. "Ferit Xhajko", , Tiranë - ALBANIA

Tel/Fax: +355 4 225 619 / 271 777 / e-mail: mekanika@dinamo-sha.com / www.dinamo-sha.com

PROCES VERBAL

I MBLEDHJES E PERGJITHESHME TE AKSIONMBAJTESAVE TE DINAMO SHA

Sot me dt. 23/12/2013 , ora 12.00 ne seline shoqerise zhvillohet mbledhja e pergjithshme e Asamblese.

Me rend dite te publikuar:

1. Ndryshime ne Keshillin Drejtues ,
2. Te ndryshme

Drejtues I mbledhjes Kryetari I Keshillit Mbikqyres Av. Dilaver Rexhepaj
Mbajtesi I procesit sekretar Merita Mullademi

Verifikohet pjesmarrja,

Te pranishem:

Z. Roland Hysa zoterues i 62.424% te aksioneve.

Znj. Migena Recì zoterues e 2.456%.

Valter Jupi, zoterues 1.228%

Ne baze te pjesmarrjes, perqindja e pranishme e kapitalmbajtesave eshte ne perputhje me ligjin dhe statutin per te marre vendimet e rendit te dites.

Pyetje dhe ceshtje te tjera per tu shqyrtuar ne kete pik te renditte dites nuk ka .
Diskutime

Z.Dilaver : Sqaron , duke patur parasysh ndryshimet si dhe impenjimin ne zgjidhjen e situatave qe jane krijuar kunder sha Dinamo per synim mbylljne e tregut ne menyre te kundraligjesheme – behet e domosdoshme qe ne keshillin mbikqyres te kete ndryshime me qellim qe te rritet efikasiteti dhe perkushtimi per t`ju pergjigjur detyrave qe ka keshilli mbikqyres ne kohen qe ka nevojë shoqeria.

Z. Valter Jupi , Edhe une jam dakort qe ka ardhur koha te kete ndryshime, pasi momentet dhe veshtiresite qe kaloi shoqeria provuan qe Keshilli Mbikqyres nuk pati asnje impenjim per te kontribuar ne keto momente te cilat tani dihen publikisht. Gjithmone ndryshimi sjell nje zhvillim te ri, por ne kete rast une mendoj qe ky keshill duhet te vazhdoje punen deri ne mbarimin e percaktuar 3 vjet dhe te nderrohet vetem nje antar, i cili ka kaluar periudhen 3-vjecare ne kete shoqeri.

Per kete shkak propozoj te shkarkohen nga Keshilli Mbikqyres Z. Xhevdet Mehmeti
Dhe ne vend te tij te jete nje antare te re e Keshillit Mbikqyres dhe pikerisht
zj. Migena Recì.

Hidhet ne votim propozimi i Z. Valter Jupi,

Votohet. Vota kunder nuk ka. Miratohet

Kalohet ne piken e dyte te rendit te dites, te ndryshme.

A - Asambleja ne shqyrtimin e materialeve te paraqitura,

KONSTATOI

1. Drejtoria e Administrimit dhe shitjes se pronaver publike ka paraqitur per shqyrtim *“portokollin I llogaritjeve te pakeses se aksioneve per ish pronartet e truallit te cilet nuk jane perfshire ne pakenet e aksioneve per ish pronarte e truallit “*

2. Drejtoria e shoqeris ka kerkuar te emrohet ekspert kontabel“per “sakesimin e llogaritjeve te numerit te aksioneve dhe menyres se shperndarjes se aksioneve te rritura ne baze te vendimeve Gjyqesor nr.7549 dt.22/12/2006 dhe 979 dt.24.07.2009 te Gjykates se Larte dhe .urdherit Nr. 332 dt. 08.05.2013 M. E.T.E ne zbatim te vendimeve Gjyqesor nr.7549 dt.22/12/2006 dhe 979 dt.24.07.2009 te Gjykates se Larte.

3. Drejtoria e shoqeris propozon per kryererjen e aktit te ekspertimit te emrohet ekspere znj. Ilda Duhaxhiu,

Ne perfundim, Asambleja, me votimin 100% te pjesemarrseve

VENDOSI:

1) Te pranoje kerkesen e Drejtoris se shoqeris “Dinamo” Sha per sakesimin e llogaritjeve ne *“portokollit te pakeses se aksioneve per ish pronartet e truallit te cilet nuk jane perfshire ne pakenet e aksioneve per ish pronarte e truallit “*dhe sakesimin e llogaritjeve te numerit te aksioneve dhe menyres se shperndarjes se aksioneve te rritura ne baze te vendimeve Gjyqesor nr.7549 dt.22/12/2006 dhe 979 dt.24.07.2009 te Gjykates se Larte dhe .urdherit Nr. 332 dt. 08.05.2013 M. E.T.E ne zbatim te vendimeve Gjyqesor nr.7549 dt.22/12/2006 dhe 979 dt.24.07.2009 te Gjykates se Larte.

2) Miratimin e ekspertes kontabel te autorizuar te shoqerise “Public Accounting Service Uninin & Trust “ shpk znj. Ilda Duhaxhiu, .

-Autorizohet drejtori i Shoqerise ne permbushje te ketij vendimi te kryej procedurat me ekspertin kontabel dhe te pregatis materialet per miratim te rezultatetve dhe aktit te eksperteimit ne mbledhjen e asmables -

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

B- Z. Dilaver

Ne baze te nje informacionit qe ka paraqitur Drejtoria, rezulton se jane perfshire ne listen e aksionmbajtesave te sha Dinamo trashgimtarët e Muharrem dhe Shyqeri Metanit, te cilat kane perfituar aksione me cilesine pronarve te truallit.

Ne baze te dokumentacionit bashkalidhur provohet qe te ndjeret Muharrem dhe Shyqeri Metani, nuk kane qene subjekte te te drejtes per njohje dhe kthim prone , pasi prona e pretenduar prej tyre dhe familjeve te tjera , ka qene dhe eshte prone e shtetit shqiptare nga viti 1940, pra keto familje jane shpronesuar kundrejte ligjit dhe per kete shkak nuk mund te fitojne te drejten te jene aksionmbajtes te kesaj shoqerie. Pikerisht per kete shkak Sha Dinamo ka vene ne levizje Gjykatën me padi kunder familjes Katroshti per shfuqizim te vendimeve te K k Pronave dhe ne perfundim gjykatat e te gjitha shkalleve kane vendosur te shfuqizojn vendimet e KK Pronave dhe pronen e perfituar prej tyre brenda teritorit te sha Dinamo tja kthejne shtetit.

Po keshtu ne kete vendim nr 303 dt 27.10.95 edhe sikur te ndodhte te ishte vertet pronar familja Metani , K. K. pronave nuk ka patur te drejten t'ja kthente truall te lire siperfaqen brenda teritorit te sha Dinamo, pasi trualli ka qene i zene , dhe per kete shkak ky vendim duhet shfuqizuar pasi ka cenuar pronen e perfshire ne kapitalin themeltar te shoqeris

Ne baze te informacionit, Drejtori i shoqeris e kerkon autorizim qe te vere ne levizje gjykatën me padi civile dhe te anagazhoje zyre avokatisë per shfuqizim te vendimeve te K.k.pronave dhene ne favor te familjes Metani si dhe ti perjashtoj nga lista e aksionmbajtesave

Duke u ndodhur para faktit qe aksionet e zotruara nga shteti, pavarsisht se ne kete rast Ministria e Ekonomis eshte nje aksioner si gjith te tjeret me te drejte vote sipas numeritte aksioneve qe zotron, ne praktiken e ndjekur ne ceshtjen Dinamo kunder familjes Katroshti, etj eshte marre pelqimi me shkrim dhe i Ministrit te Diskutime te tjera nuk ka.

Te autorizohet Drejtori i pergjithshem qe te perfaqesoje Asamblen e aksionmbajtesave dhe aksioneret e pranimesh ne kete mbledhje ne menyre nominale qe te vere ne levizje gjykatën me padi civile per cfuqizimin e vendimeve te K.k.pronave te dhena ne favor te familjes Metani si dhe te kerkoj perjashtimin e tyre nga lista aksionmbajtesave -me te drejten te angazhoj nje zyre avokatie me delegim kopetencash procedurjale

Mbledhja deklarohet e mbyllur

Hidhet ne votim mirastohet

P/ASAMBLENE E AKSIONMBAJTESAVE

KRYETAR




Dilaver Rexhepaj



SEKRETAR

Merita Mullademi



- Roland Hysa 
- Mipen Rexhepaj 
- Valter Fupi 

PROCESVERBAL DHE VENDIM

I MBLEDHJES SE PERGJITHSHME

TE AKSIONMBAJTESAVE TE DINAMO SHA


I mbajtur sot me datë 16.03.2015 ora 10^{oo}, në Tiranë, pranë selisë së shoqërisë Dinamo sha, për mbledhjen e asamblesë së aksionareve të shoqërisë "Dinamo" sha Tirane. Shoqëria "Dinamo" sha Tiranë është regjistruar si person juridik në regjistrin tregtar, me vendimin nr. 12870, datë 24.11.1995, të Gjykatës Tiranë dhe ushtron aktivitetin e saj në qytetin e Tiranës, me NIPT J61819012V.

Jane prezent ne mbledhjen e datës 16.03.2015 ora 10.00 :


1. Z. Roland Hysa zoterues 48.33 % te kapitalit themeltar



2. Znj. Migena Reçi zoteruese 3.9 % të kapitalit themeltar



3. Z.Valter Jupi, zoterues 2.2% te kapitalit themeltar



Nuk ka perfaqesues te aksionerit shtet qe perfaqeson Ministrin e MZHETS Z.Arben Ahmetaj - 13.38 % të kapitalit themeltar te shoqërisë apo aksionare te tjere.

Korumi i kerkuar nga ligji dhe statuti plotesohet, per te vazhduar me tej me zhvillimin e mbledhjes.

Kjo mbledhje u zhvillua në zbatim të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe me fillimin e mbledhjes u caktua:

Aksionaret vendosen qe mbledhjen ta drejtoje znj. Migena Reçi, duke e caktuar ate si kryetare te mbledhjes se sotme. Kryetari i caktuar i mbledhjes verifikon paraprakisht rregullsinë e njoftimit dhe përfaqësimit të aksionareve dhe pasi i konsideron të rregullta, deklaroi mbledhjen të hapur.

Më pas propozohet kalimi në rendin e ditës,

- Znj. Migena Reçi kryetar që drejton mbledhjen
- Z. Ledio Milkani mbajtësi procesverbalit

Rendi i ditës i mbledhjes se parashikuar eshte :

1. Miratimi i pasqyrave financiare per vitin 2014.
2. Miratimi i planit te zhvillimit per vitin 2015.
3. Emerim antari te Keshillit Mbikqyres te shoqërisë.
4. Depozitimin prane QKR-se te Urdherave te Ministrit Ekonomik, Tregtise dhe Sipermarrjes nr. 466, date 31/10/2014 dhe nr. 359, date 01/07/2014.



5. Diskutimi dhe marrjen e nje vendimi nga shoqeria per ecurine e procesit te privatizimit te paketes shtetore lidhur me ndryshimet e fundit te miratuara, nga qeveria mbi proceduren e privatizimit ne shoqerite tregtare.
6. Dhenie autorizimi nje studio avokatie, lidhjen e kontrates dhe fillimin e procesit gjyqesor kunder disa aksionereve te shoqerise.
7. Te ndryshme.

Diskutime:

Lidhur me piken e pare te rendit te dites,

Z. Roland Hysa u shpreh se : meqe nuk kane perfunduar dhe nuk u jane dorezuar aksionareve pasyrat financiare te perfunduara kjo pike te mos diskutohet ne kete mbledhje. Ne keto kushte propozoj qe ne menyre konsensuale qe kete pike ta shtyjne per ta shqyrtuar ne nje mbledhje tjeter dhe ti japim kohen e duhur strukturave te shoqerise qe te perfundojne materialin.

Lidhur me piken e dyte te rendit te dites,

Z. Roland Hysa mori fjalen dhe u shpreh se nese pasqyrat financiare nuk kane perfunduar nuk ka kuptim qe te diskutohet per piken e dyte te rendit te dites.

Aksionaret e tjere jane te te njetit mendim se miratimi i kesaj pike lidhet drejtperdrejt me miratimin e pikes se pare.

Ne keto kushte u pranua njezeri qe edhe kjo pike te mos shqyrtohet ne kete mbledhje, por te shqyrtohet ne nje mbledhje tjeter.

Lidhur me piken e trete te rendit te dites,

Z. Valter Jupi u shpreh se ka perfunduar mandati i anetarit te Keshillit mbikqyres Znj. Shpresa Breçani dhe i anetarit Z. Dilaver Rexhepaj prandaj i propozon asamblese qe te propozoje per plotesimin e keshillit mbikqyres ku dhe propozoi qe ne vend te anetarit Znj. Shpresa Breçani te zgjidhet z.Gjergji Kosta, me nje mandat qe fillon nga data e sotme per nje periudhe 3 vjecare.

Hidhet ne votim . Miratohet.

Lidhur me Anetarin Z. Dilaver Rexhepaj, u propozua nga Z. Roland Hysa, qe mandati i ketij anetari te rinovohet edhe per nje periudhe tjeter 3 vjecare nga data e perfundimit te mandatit parardhes per arsye te punes se mire qe ky anetar ka bere gjate kohes qe ka qene i zgjedhur.

Hidhet ne votim . Miratohet.

Lidhur me piken e katert te rendit te dites,

Z. Roland Hysa u shpreh se meqe deri tani nuk ishin dorezuar ne QKR keta urdhera, qe lidhen me procesin e privatizimit te paketes shtetore mendoj se duhen te depozitohen prane QKR-se. Znj. Migena Recic dhe Z. Valter Jupi u shprehen qe jane dakort me propozimin e Z. Roland Hysa qe te depozitohen prane QKR-se dy Urdherat e Ministrit Ekonomik, Tregtise dhe Siperarrjes

nr. 466, date 31/10/2014 dhe nr. 359, date 01/07/2014, pasi per keta urdhera asambleja e aksionareve ka miratuar fillimin e procedures se privatizimit te aksioneve te aksionarit shtet.

Lidhur me piken e peste te rendit te dites,

Aksionari Valter Jupi u shpreh se Asambleja e pergjithshme e shoqerise i ka dhene miratimin aksionarit shtet qe te shese aksionet e tij, duke respektuar statutin dhe legjislacionin ne fuqi, ne kohen qe procesi i privatizimit te aksioneve te shoqerise dhe legjislacioni specifik per kete proces ishte VKM nr. 119, date 18.03.2000. Po kete qendrim ka mbajtur edhe perfaqesuesi i shtetit ne mbledhjen e asamblese te dates 03.10.2014, por veprimet e mepasme te aksionarit shtet po devijojne dhe po mbeshteten ne disa ndryshime te akteve nenligjore qe vijne ne kundersiztim me qellimin per te cilin asambleja e pergjithshme e shoqerise vendosi qe te jape miratimin per fillimin e procedures se shitjes se aksioneve te aksionarit shtet. Situata pas ketij vendimi ka ndryshuar si pasoje e ndryshimit qe ka pesuar VKM nr. 119, date . Ne keto kushte duket se procesi i privatizimit te aksioneve te aksionarit shtet nuk po respekton proceduren e nisur, por kerkon qe te vazhdoje veprimet me aktet nenligjore te ndryshuara. Ky veprim vjen ne kundersiztim me parimet baze te mirebesimit dhe te interpretimit te legjislacionit, dhe ceshte me e rendesishmja vjen ne kundersiztim me interesat e shoqerise duke krijuar nje rritje artificiale te vleres se aksioneve te aksionarit shtet. Nese procesi i privatizimit te aksioneve te aksionarit shtet, ka nisur me rregulla dhe procedure te percaktuar me VKM nr. 119 date 18.03.2000, sic eshte privatizuar dhe 10.8% e aksioneve te shtetit ne vitin 2003. Pra me ankand nisur nga vlera nominale dhe ankandi te percaktoje vleren reale te tregut, vlere tjeter nuk egziston, ka vetem 2 vlera, vlere nominale dhe vlere reale. Edhe ne kete rast po me te njejten VKM nr. 119 date 18.03.2000, duhet te perfundoje procesi i privatizimit te 13.8%. Pra ne vijim te sa u shpreha i kerkoj asamblese qe ne kete mbledhje te pezullohet miratimi i dhene ne mbledhjen e dates 03.10.2014 derisa te pranohet nga aksionari shtet qe te vazhdoje procesin e privatizimit sipas akteve ligjore dhe nenligjore ne kohen e dhenies se miratimit nga asambleja.

Aksionari Z. Valter Jupi u shpreh se bashkohet me mendimin e aksionarit Z. Roland Hysa.

Znj. Migena Recu u shpreh se ky veprim i aksionarit shtet nuk eshte i drejte dhe ne si asamble kemi te gjitha tagrin qe te kerkojme te respektohet procedura e nisur dhe legjislacioni i kohes kur kjo procedure ka nisur. Jo vetem aksionari shtet, por asnje aksionar nuk mund te veproje ne kundersiztim me ligjin dhe rregullat e shoqerise, prandaj mendoj se miratimi i dhene ne mbledhjes e kaluar duhet te pezullohet ne kete mbledhje.

Te gjitha aksionaret pjesemarres vendosen te pezullojne miratimin e dhene ne mbledhjen e Asamblese te pergjithshme te dates 03.10.2014 ndaj lejimit te fillimit te procedures se shitjes se aksioneve te aksionarit shtet per 13.38% të kapitalit themeltar te paketes shteterore, deri sa aksionari shtet te respektojte legjislacionin ne kohen e nisjes se kesaj procedure.

Hidhet ne votim . Miratohet.

Lidhur me piken 6 te rendit te dites, Kryetari i Keshillit Mbikqyres, informoi asamblene me rezoluten e meposhtme :



Te nderuar znj. Z. Aksionere,

Keshilli Mbikqyres e gjykon t'ju informoje me kete rezolute. Ne baze te dokumentacionit juridik qe i eshte vene ne dispozicion drejtorise se shoqerise rezulton se :

Zyra e rregjistrimit te pasurive te paluajtshme per pronen e sha Dinamo leshon certifikata pronesie me mbivendosje me pasurite qe u jane njohur dhe kthyer disa familjeve qe pretendojne sa kane qene ish pronar para 29/11/1944.

Konkretisht :

Familja Metani me vendimin Nr.304 date 27.10.1995 Komisioni i kthimit te pronave u eshte njohur pronesia per nje siperfaqe trualli = 8687m². Brenda prones se sha "Dinamo"- ndodhet vetem nje pjese e saj. Po ashtu u eshte kthyer ne pronesi truall i lire 1181m². Gjithashtu me te drejtat reale te fituara me kete vendim absolutisht te pavleshme ne shkembim te truallit te njohur kane perfituar nga privatizimi 0,3102455% te kapitalit themeltar te sha "Dinamo "

Familja Fortuzi KK Pronave u ka njohur me vendimin Nr. 132 dt. 28/06/1995 ish pronareve 18 dynym tok ne piken "1.b" I kthen truall I lire siperfaqe 1512m² dhe S = 2380m² qe ndodhen brenda territorit uzines "Dinamo"

Po keshtu eshte vepruar me **Familjen Daja, Kallushi, Gjinali** ,

Keto familje, pavarsisht se kane qene dhe jane ne dijeni qe nuk kane qene pronar pasi trashgimlensit e tyre me dekretin Nr.178 date 11.12.1939 botuar ne Fletoren Zyrtare nr.132 date 21.12.1939 jane shpronesuar per interes te ndertimit te gazermave te artilerise te Ushtrise Shqiptare kundrejt shperblimit.

Per ti dhene nje zgjidhje perfundimtare te konflikteve te pronesise krijuara midis pretendimeve te ketyre familjeve me pronen e shoqerise Dinamo sha, duke u ndodhur para faktit qe nje pjese e tyre kane perfituar aksione ne kapitalin e shoqerise konform ligjit per shoqerite tregtare dhe tregtaret eshte ne kompetencen e asamblese se pergjithshme per te marre vendime te vlefshme per te vendosur cfare procedure do ndiqet per eliminimin e konflikteve.

Per efekte te kesaj zgjidhje PARASHTROJME:

E vetmja mundesi per ti dhene zgjidhje ketij konflikti eshte rruga gjyqesore me padi civile ose administrative - per te shfuqizuar vendimet, zhdukur mbivendosjet, kthimin e aksioneve te perfituara padrejtesisht ndaj aksionerit shtet Ministrise se Finacave Drejtoria e Administrimit dhe Privatizimit te Prones Publike.

Te autorizohet nje studio ligjore me kompetenca te detajuara te miratuara nga asambleja per te perfaqesuar asamblene ne Gjykimet civile per te shfuqizuar vendimet, zhdukur mbivendosjet, kthimin e aksioneve te perfituara padrejtesisht ndaj aksionerit shtet Ministrise se Financave Drejtoria e Administrimit dhe Privatizimit te Prones Publike.

Te miratohet me vendim te asamblese projekt - padia dhe autorizimi perkates me te drejta studios ligjore qe te beje shtesa ndryshime ne objektine padise, pa qene nevoja per miratim tjeter.

Nje kopje te vendimet qe do merren ne kete mbledhje ti dergohen Ministrise se Financave Drejtoria e Administrimit dhe Privatizimit te Prones Publike qe perfaqeson paketen e aksioneve te pa privatizuara. Me propozimin qe nese e gjykojne te vene padi me vete.

Bashkengjitur projekt padia.

Aksionaret prezente u shprehen njezeri se miratojne rezoluten e kryetarit te keshillit mbikqyres dhe padine bashkengjitur.

Rezoluta dhe padia bashkengjitur hidhet ne votim . Miratohet.

Ne lidhje me piken e rendit te dites te ndryshme, Administratori i shoqerise kerkoj fjalën kryetarit dhe i ben me dije aksionaret se ne baze te ligjit per shoqerite tregtare i ndyshuar, kerkon qe te gjithë aksionaret te depozitojne prane shoqerise nje kopje te dokumentit te identifikimit (karte ose pasaporte biometrike), per te mos bllokuar veprimtarine e shoqerise ne raport me QKR.

Aksionaret lidhur me kete problem vendosen qe drejtoria te beje nje njoftim ne 2 gazeta te perditshme me tirazh te madh dhe me pas nje kerkese prane Qendres se Rregjstrimit te Aksioneve per te siguruar dokumentat e identifikimit te aksionareve.

Hidhet ne votim . Miratohet.

Ne perfundim u kalua ne marrjen e vendimit si me poshte, ku asambleja e pergjithshme e aksionareve :

VENDOSI :

1. Te shtyhet per ne mbledhjen e ardhshme miratimi i pasqyrave fiandare per vitin 2014.
2. Te shtyhet per ne mbledhjen e ardhshme miratimi i planit te zhvillimit per vitin 2015.
3. Te emeruje si anetar te keshillit Mbikqyres te shoqerise Dinamo sha. Gjergji Kosta. Emerimi fillon nga dita e sotme dhe perfundon drei me date 16.03.2018. Te rinovoje mandatin e Z. Dilaver Rexhepaj edhe per nje periudhe tjeter 3 vjecare, duke filluar nga data e perfundimit te mandatit parardhes 14/06/2014 deri me date 14/06/2017.
4. Te miratoje depozitimin prane QKR-se te Urdherave te Ministrit Ekonomise, Tregtise dhe Siper marrjes nr. 466, date 31/10/2014 dhe nr. 359, date 01/07/2014.
5. Te pezulloje miratimin dhe lejen e dhene per fillimin e prodcedures per privatizimin e aksioneve te paketes prej 13.38% te Aksionarit shtet e (Ministria e Ekonomise) deri ne nje moment te mevonshem me kushtin qe procedura e nisur te zbatohet sipas legjislacionit ne fuqi ne momentin e miratimit te Urdherave te Ministrit Ekonomik, Tregtise dhe Siper marrjes nr. 359 date 01/07/2014 dhe nr. 466 date 31/10/2014.



6. Te miratoje rezoluten e Keshillit mbikqyres. Te miratoje projekt-padine per shfuqizimin e vendimeve te Komisionit te Kthimit te Pronave dhene ne favor te familjeve Metani, Fortuzi, Daja, Kallushi dhe Gjinali, ne pronen e shoqerise Dinamo sha si dhe largimin e trashegimtareve te ketyre familjeve si aksionare te shoqerise Dinamo sha per aksionet e perfituara padrejtesisht duke u paraqitur si ish-pronare ne nje kohe qe trashegimlensit e tyre me dekretin nr. 178 date 1939 botuar ne fletoren zyrtare nr. 132 date 21.12.1939 jane shpronuesuar per interes te ndertimit te gazermave te artilerise se ushtrise italiane kundrejt demshperblimit.
7. Te jape autorizimin studios se Avokatisë "Rexhepaj & Kambo" shpk e identifikuar me NIPT K72002020W, Av. Dilaver Rexhepaj e Nexhdet Kambo, te dy se bashku ose veç e veç, si dhe te delegoje me autorizim kompetenca per te perfaqesuar asamblene e pergjithshme ne gjykime civile dhe administrative me objekt shfuqizimin e vendimeve te Komisionit te Kthimit te Pronave per familjet Metani, Fortuzi, Daja, Kallushi dhe Gjinali, qe u kane njohur dhe kthyer ne pronesi mbi pronen e shoqerise Dinamo sha, perjashtimin e tyre si aksionmbajtes per aksionet e perfituara padrejtesisht duke u paraqitur si ish-pronare. Te perfaqesoje Asamblene e Pergjithshme ne te gjitha shkallet e gjykimit ne gjykatën e rrethit gjyqesor, Gjykatën Administrative te shkalles se pare, te Apelit Civil dhe Administrativ dhe ne gjykatën e Larte Kolegjin Civil dhe Administrativ me cilesine e paditesit, pales se paditur kunderpadites, nderhyres kryesor, dytesor, personit te trete, me te drejten e nenshkrimt te kerkese padive, kunderpadive, nderhyresit kryesor, dytesor, person i trete, te percaktoje objektin dhe ndergjyqesine, te prashtroje me shkrim te nenshkruara prej tyre kerkesa, ankesa, parashtrime, ankim ne gjykatën e apelit civil dhe administrativ dhe ne gjykatën e larte kolegjin civil dhe administrativ, te emeroje ekspert, si dhe te delegoje kompetenca te ketij autorizimi avokateve te studios.

Procesverbali bashke me vendimin mbahen në 5 (pese) kopje, në prani të aksionarëve prezente dhe firmoset prej tyre, të cilët marrin nga një kopje.

P/ASAMBLENE E AKSIONMBAJTESAVE

KRYETAR
Migena Reçi

SEKRETAR
Ledio MILKANI

AKSIONARET

1.

2.

3.

Rolaud Hysa
Migena Reçi
Valter Fupi

Ledio Milkani

PROCESVERBAL DHE VENDIM

I MBLEDHJES SE ZAKONSHME

TE AKSIONEREVE TE "DINAMO" SHA

Mbajtur sot me datë 25.03.2016 ora 12.00, në Tiranë, pranë selisë së shoqërisë Dinamo Sha, mbi mbledhjen e Asamblesë së Zakonshme të Aksionereve të shoqërisë "Dinamo" Sha Tirane. Shoqëria "Dinamo" Sha Tiranë është regjistruar si person juridik në regjistrin tregtar, me vendimin nr. 12870, datë 24.11.1995, të Gjykatës Tiranë dhe ushtron aktivitetin e saj në qytetin e Tiranës, me NIPT J61819012V.

Jane prezent ne mbledhjen e datës 25.03.2016 ora 12.00 :

1. Z. Roland Hysa, zoterues 48.801 % te kapitalit themeltar
2. Zj.Migena Recì, zoterues 3.9 % të kapitalit themeltar
3. Z.Valter Jupi, zoterues 2.2 % te kapitalit themeltar

Korumi i kerkuar nga ligji dhe statuti plotesohet, per te vazhduar me tej me zhvillimin e mbledhjes.

Kjo mbledhje u zhvillua në zbatim të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe me fillimin e mbledhjes u caktua:

- * Z. Dilaver Rexhepaj kryetar që drejton mbledhjen
- * Zj.Migena Recì mbajtësi procesverbalit

Z. Dilaver Rexhepaj, që drejton mbledhjen, verifikon paraprakisht rregullsinë e njoftimit dhe përfaqësimit të ortakëve dhe pasi i konsideron të rregullta, deklaron mbledhjen të hapur.

Rendi i ditës i mbledhjes se parashikuar eshte :

1. **Miratimi i bilancit dhe pasqyrave financiare per vitin 2015.**
2. **Miratimi i planit te zhvillimit per vitin 2016.**
3. **Zgjedhja e Keshillit Mbikqyres.**
4. **Te ndryshme.**

Z.Nexhip Meci, administrator i Shoqërisë, paraqet raportin e treguesve financiare te vitit 2015. Ne te theksohet se treguesit e bilancit te Shoqërisë "Dinamo" Sha per vitin 2015, paraqiten si vijon:

A- Totali i te ardhurave	56.901.466 leke
B- Totali i shpenzimeve	73.566.780 leke
Rezultati financiar (A-B)	-16.665.314 leke
Tatim fitimi	0
Fitimi/humbja neto	-16.665.314 leke

Pra, rezultati financiar i Shoqërisë "Dinamo" Sha per vitin ushtrimor 2015, per te cilin do te miratohet bilanci ne kete mbledhje Asambleje eshte humbje -16.665.314 leke

Materiali i plote i bashkengjitet dosjes se mbledhjes.

Diskutime:

Lidhur me piken e pare te rendit te dites,

Zj.Migena Reci u shpreh se :

Jam dakord me materialin e paraqitur nga ana e administratorit te Shoqerise. Renia e te ardhurave si pasoje e largimit te tregtareve te tregut me shumice e pakice te fruta-perimeve ne vitin 2014, u ndje dhe ne rezultatin financiar te ketij viti ushtrimor qe po analizojme. Edhe pse eshte punuar per thithjen e tregut industrial, kurrsesi nuk mund te pretendohet per arritjen e nivelit te te ardhurave te realizuara ne vitet e meparshme. Per rrjedhoje, une shprehem pro miratimit te treguesve ekonomiko-financiare te Shoqerise Dinamo Sha per vitin 2015.

Z.Valter Jupi. Jam dakord me materialin e paraqitur dhe miratoj pasqyrat financiare te vitit 2015 me rezultatin ne humbje prej 16.665.314 leke.Gjithsesi, kjo nuk e ka bazen ne punen e strukturave te Shoqerise, por ne largimin masiv te imponuar te tregtareve nga Tregu Dinamo.

Votohet pika e pare e rendit te dites.

Pro 3 votues, kunder asnje.

Miratohet.

Lidhur me piken e dyte te rendit te dites, Plani i zhvillimit ekonomik per vitin 2016, e merr fjalen z. Nexhip Meci, i cili paraqet planin e zhvillimit 2016. Nder te tjera, ne kushtet e reja te krijuara per Shoqrine Dinamo dhe te pamundesise financiare te kryerjes se investimeve kapitale, propozohet kryeja e mirembajtjes dhe riparimeve te domosdoshme ne treg, si me poshte:

1-Kryerja e punimeve te mirembajtjes te banjove ekzistuese.

2-Mirembajtje e kanalizimeve dhe pastrimi i pusetave.

3-Pergatitje e Sheshit nr. 2 per tregtimin e rrobave te perdorura.

Z.Roland Hysa. Mendoj se eshte e drejte te parashikohen shpenzime per 2016 vetem per mirembajtje e riparimet me te domosdoshme per tregun dhe kanalizimet.

Z.Valter Jupi,u shpreh se viti 2016 duhet te jete nje vit qe te shenoje kthese ne ngjitje dhe ne kete aspekt. Por, kushtezuar nga situata financiare, Shoqerise i diktohet te beje shpenzime per riparime e mirembajtje te domosdoshme te ambienteve te saj. Prandaj, jam dakord dhe e miratoj planin e zhvillimit te vitit 2016, ne drejtimet qe paraqet z. Meci.

Hidhet ne vote miratimi i pikes se dyte te rendit te dites.

Votohet, pro 3 votues, kunder asnje.

Miratohet

Kalohet ne piken e trete te rendit te dites,``Te ndryshme``, ku ne sekretari jane depozituar keto materiale per diskutim:

1-Doreheqja e zj. Migena Reci si antare e Keshillit mbikqyres te Shoqerise.

2-Propozimi per zgjedhjen e z. Theodhor Kristuli si antar i ri i Keshillit Mbikqyres

3-Caktimi i eksperteve kontabel per auditimin e pasqyrave financiare te Shoqerise Dinamo per vitin 2016 . Propozimi ne sekretari per zj.Stoli Laze dhe z. Ilia Cece.

Diskutime:

Per piken e pare te rendit te dites miratohet kerkesa e depozituar ne sekretari e zj. Migena Recu per largimin nga Keshilli Mbikqyres.

Miratohet z.Theodhor Kristuli si antar i ri i Keshillit Mbikqyres.

Gjithashtu miratohet propozimi per dy ekspertet per vitin 2016 zj. Stoli Laze dhe z. Ilia Cece.

Hidhet ne votim.

Miratohen njezeri.

Ne perfundim u kalua ne marrjen e vendimit si me poshte, ku Asambleja e Zakonshme e Aksionereve te Shoqerise ``Dinamo`` Sha,

VENDOSI :

1. Te miratohen treguesit e bilancit finciar per vitin 2015 me humbjen e realizuar ne shumen -16.665.314 leke.
2. Te miratohet plani i zhvillimit ekonomik te Shoqerise per vitin 2016.
3. Te miratohet doreheqja e zj.Migena Recu si antare e Keshillit Mbikqyres.
4. Te emeruje si antar te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise ``Dinamo``Sha z. Theodhor Kristuli. Emerimi fillon nga dita e sotme date 25.03.2016 dhe perfundon me date 25.03.2019.
- 5-Te miratohen eksperte kontabel per auditin e pasqyrave financiare te vitit 2016 per Shoqerine ``Dinamo``Sha zj.Stoli Laze dhe z. Ilia Cece.

Te depozitohet ky vendim prane Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane dhe QKR. Ngarkohet Administratori i Shoqerise ``Dinamo``Sha.

Procesverbali bashke me vendimin mbahen ne 5 (pese) kopje, ne prani te aksionarëve prezente dhe firmoset prej tyre, te cilët marrin nga një kopje.

P/ASAMBLENE E AKSIONMBAJTESAVE

KRYETAR

Dilaver Rexhepaj

SEKRETAR

Migena Recu

Aksioneret:

1-

2-

3-

Edmond Hysa
Valter Rexhepaj

Migena Recu

V E N D I M
I M B L E D H J E S S E Z A K O N S H M E
T E A S A M B L E S E S E A K S I O N E R E V E T E " D I N A M O " S H A

Mbledhja e zakonshme e aksionereve te Shoqerise ``Dinamo``Sha, mbledhur sot me date 31/10/2017, ora 12.00, ne seline e kesaj Shoqerie, pasi mori ne shqyrtim dhe diskutoi mbi rendin e dites, si me poshte:

- 1) Emerimi i nje Antari te Keshillit Mbikqyres.
- 2) Miratimi i Draft-Kontrates per shitjen e Prones Truall, me Siperfaqe Totale te Pasurise 3941m2, Zk 8340, nr pasurie 3/553. Tirane.
- 3) Te ndryshme

Me pjesmarrjen e 65.863 % te aksionereve, Asambleja e aksionmbajtesve ,

V E N D O S I :

1. Emerimin ne detyre te antarit te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise sha "Dinamo" Z.Dilaver Rexhepaj. Emerimi fillon nga dita 31/10/2017 dhe perfundon 31/10/2020.
2. Miratimin e projekt kontrates se shitjes se tokes ne favor te z.Roland Hysa.
3. Te Autorizojte znj.Migena Recu ne cilesine e Administratores te neshkruaje kontraten e shitjes e truallit ne favor te z. Roland Hysa.

Te depozitohet ky vendim prane QKB dhe ZRPP . Ngarkohet Administratori i Shoqerise ``Dinamo``Sha per zbatimin e ketyre vendimeve.


K R Y E T A R

S E K R E T A R

DILAVER REXHEPAJ



MERITA MULLADEMI



VENDIM
I MBLEDHJES SE ZAKONSHME
TE AKSIONEREVE TE "DINAMO" SHA
(I SHKURTUAR)

Mbledhja e zakonshme e aksionereve te Shoqerise "Dinamo" Sha, e mbledhur sot, ne date 16/07/2018, ora 12.00 ne seline e kesaj Shoqerie, pasi mori ne shqyrtim dhe diskutoi mbi rendin e dites si me poshte:

- 1.Miratimi treguesve ekonomiko-financiare per vitin 2017.
- 2.Miratimi i planit te zhvillimit te Shoqerise per vitin 2018.
- 3.Zgjedhja e nje antari te ri te Keshillit Mbikqyres.
- 4.Te ndryshme.

Me pjesmarrjen e 68.865 % te aksionereve , Asambleja e aksionmbajtesve ,

VENDOSI :

- 1-Te miratohen treguesit ekonomiko-financiar te bilancit te vitit 2017 me fitim te realizuar ne shumen **1.642.723 leke**.
- 2-Fitimi i vitit 2017 te kaloj per investime.
- 3-Te miratohet plani i zhvillimit ekonomik te Shoqerise per vitin 2018.
- 4 -Emerimin ne detyre te antarit te ri te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise "Dinamo Sha " Z. Bajram Hysa, Emerimi fillon nga data 16.07.2018 dhe perfundon me 16.07.2021.
- 5-Te miratohen eksperte kontabel per auditin e pasqyrave financiare te vitit 2018 Shoqeria "S&E Laze Audit" dhe z. Ilia Cece.

Te depozitohet ky vendim prane Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane dhe QKB. Ngarkohet Administratori i Shoqerise "Dinamo" Sha per zbatimin e ketyre vendimeve.

Procesverbali bashke me vendimin mbahen ne 5 (pese) kopje.

P/ASAMBLENE E AKSIONMBAJTESAVE


DREJTUESI I MBLEDHJES

Migena RECI



SEKRETAR

Merita MULLADEMI



VENDIM I KESHILLIT MBIKQYRES
DINAMO SH.A .

Nr. 62

I mbledhur sot, më datë 30/07/2019, Këshilli Mbikqyrës i "Dinamo" Sha, mori ne shqyrtim rendin e dites si vijon :

1. Emerimin e Administratores te Shoqerise.
2. Te ndryshme

Keshilli Mbikqyres, pas diskutimeve lidhur me pikat e parashikuara ne rendin e dites,

K O N S T A T O J

- 1) Me vendimin Nr. 54 dt, 31.05.2016 Keshilli Mbikqyres ka vendosur te emroj ne detyren e Administratores se Shoqeris znj. Migena Recii-
- 2) Ne baze te statutit afati i koheqendrimit ne detyre znj. Migena Recii i perfundon ne date 01.06.2019,
- 3) Ne konsultimet paraprake me nje koruim aksioneresh qe zotrojn mbi 50% te aksioneve si dhe duke u bazuar ne faktin qe nuk ka asnje kerkes tjeter per te kandiduar pervec znj. Migena Recii

Keshilli Mbikqyres ne perfundim

VENDOSI

- 1- Te emroje ne detyren e Administratores sha "Dinamo " znj. Migena Recii, duke filluar nga data 01/06/2019 . me te njejten page .
- 2-Te behet depozitimi i ketij Vendimi ne QKB brenda afateve ligjore.
- 3-Per zbatimin e kesaj detyre ngarkohet znj. Migena Recii.

Kryetari Keshillit Mbikqyres


Dilaver Rexhepaj

Anetar





Anetar

THEODHOR KRITULI



BAJRAM HYSA



PROCESVERBAL DHE VENDIM

I MBLEDHJES SE ZAKONSHME

TE AKSIONEREVE TE "DINAMO" SHA

Mbajtur sot me datë 26/04/2019 ora 11.00 në Tiranë, në ambientet e Hotel Diplomat mbi mbledhjen e Asamblesë së Pergjithshme të Aksionereve të shoqërisë "Dinamo" Sha Tirane. Shoqëria "Dinamo" Sha Tiranë është regjistruar si person juridik në regjistrin tregtar, me vendimin nr. 12870, datë 24.11.1995, të Gjykatës Tiranë dhe ushtron aktivitetin e saj në qytetin e Tiranës, me NIPT J61819012V.

Rendi i ditës i parashikuar për këtë mbledhje është :

1. **Miratimi i treguesve ekonomik për vitin 2018.**
2. **Miratimi i Planit të Zhvillimit për vitin 2019.**
3. **Zgjedhja e nje antari te ri te Keshillit Mbikqyrës.**
4. **Te ndryshme.**

Të pranishëm në mbledhjen e datës 26 Prill 2019, ora 11.00 :

Z. Roland Hysa,	zoterues	46.943 %	të kapitalit themeltar
Z. Valter Jupi,	zoterues	2.200 %	të kapitalit themeltar
Z. Enea Hysa,	zoterues	2.000 %	të kapitalit themeltar
Zj. Migena Recì,	zoterues	3.901 %	të kapitalit themeltar
Zj. Ermira Hysa,	zoterues	6,274 %	të kapitalit themeltar
Z. Bajram Hysa	zoterues	0.978 %	të kapitalit themeltar
Z. Arjan Hysa	zoterues	2.411 %	të kapitalit themeltar

Roland Hysa
Valter Jupi
Enea Hysa
Migena Recì
Ermira Hysa
Bajram Hysa
Arjan Hysa

Korumi i kerkuar nga ligji dhe statuti plotesohet, për të vazhduar më tej me zhvillimin e mbledhjes. "Totali i kapitalit të zotëruar nga aksionerët e pranishëm është 64.707 % (gjashtedhjetë e katër e shtatëqind e shtatë %) pjesëmarrje e cila plotëson përqindjen e nevojshme që kjo mbledhje të quhet e ligjshme në zbatim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Për drejtimin e mbledhjes, Z. Bajram Hysa propozon që mbledhja të drejtohet nga zonja Migena Recì.

Hidhet në votim ky propozim.

Pro 100 % e aksionereve të pranishëm.

Kunder asnje,

Miratohet!

Znj. Migena Recì

Drejtuuesi i Mbledhjes,

Z. Valter Jupi

Sekretar, mbajtësi i procesverbalit.

Drejtuesja e mbledhjes Znj. Migena Reci, verifikon paraprakisht rregullsine e njoftimit dhe përfaqësimit të ortakëve dhe pasi i konsideron të rregullta për zhvillimin e mëtejshëm të mbledhjes dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, deklaroi mbledhjen të hapur dhe hap diskutimet për pikën e parë të rendit të ditës :

1. Miratimi i treguesve ekonomik per vitin 2018.

Zj. Migena Reci - Paraqet raportin e treguesve financiar te vitit 2018, ku rezultati financiar i Shoqërisë për vitin ushtrimor 2018 për të cilin do të miratohet në këtë mbledhje Asambleje paraqitet në raportin prezent në këtë mbledhje. Materiali i plote i bashkangjitet dosjes se mbledhjes.

Per kete pike nese ka pyetje?

Pyetje ?

Z. Valter Jupi – Duke degjuar raportin qe ju prezantuat dhe treguesit financiar, do te doja te dija se sa e keni planifikuar rritjen e fitimit per vitin 2019 ?

Znj. Reci - Fitimi nuk do te jete shume i madh pasi nuk bazohet ne rritjen e qerases por do te bazohet ne uljen e shpenzimeve, pasi sic e thashe per kete vite jemi fokusuar tek ndarja e tarifes se sherbimit nga tarifa e qerases. Duam qe tek tregtaret te fusim konceptin e ndarjes se tarifes se qerases nga tarifa e sherbimeve.

Persa i perket normave te qerases Shoqeria nuk aplikoj rritje per vitin 2018, duke qene se Bordi Mbikqyres vleresoj faktin qe ne jemi nje treg ne ri-mekembje dhe si i tille kerkohej qe tu japim kohen e duhur tregtareve per te ngritur punen prane ketij tregu.

Pyetje ?

Z. Roland – Mos do te ishte me mire qe pas investimeve qe jane bere me kamera ambjentet jane me te kontrolluar si rezultat mos do ishte me mire te shihej mundesia e uljes se numrit te punonjesve qe merren me ruajtjen e tregut?

Znj. Reci-Kjo eshte mese e drejte e kemi menduar disa here, dhe ne 6- mujorin e dyte mendojme te bejme dhe shkurtime te tjera te cilat do te zvoglojne shpenzimet e shoqerise.

Diskutime te tjera ka – Nuk ka !

Mbyllet diskutimet dhe hidhet ne votim, pika e pare e rendit te dites:

Pro 100 % e aksionereve te pranishem!

Kunder asnje.

Miratohet pika e pare e rendit te dites: Miratimi i treguesve ekonomiko-financiar per vitin ushtrimor 2018.

Autorizohet Drejtoria per ekzekutimin e ketij Vendimi.



Kalohet ne piken e dyte te rendit te dites: – Miratimi i Planit te Zhvillimit per vitin 2019.

Znj. Reci – Lexon raportin e zhvillimit per vitin 2019 , nder te tjera ka parashikuar qe ne kontrate te shtohet tarifa e sherbimit duke e vecuar nga tarifa e qerases, duke krijuar keshtu konceptin tek tregtaret te pageses se sherbimeve si kosto ekstra, e cila mendojme do te mbuloj ne rreth 30 % shpenzimet qe shoqeria ka per sherbimet si pastrim, mirembjatje e ruajtje. Gjithashtu nje pike tjeter e rendesishme eshte dhe sistemimi i tregut ambulant ne nje zone te perkohshme.

Pyetje e diskutime ? – Nuk ka !

Hidhet ne votim pika e dyte e rendit te dites.

Pro 100 % e aksionereve te pranishem!

Kunder asnje.

Miratohet pika e dyte e rendit te dites – Miratimi i Planit te Zhvillimit per vitin 2019.

Kalohet ne piken e 3 te , Zgjedhja e nje Antari te Ri te Keshillit Mbikqyres.

Znj. Reci- Antarit te Keshillit Mbikqyres Z. Theodhor Kristuli i ka mbaruar mandati, sipas ligjit per Shoqerite Tregtare dhe Statutit duhet zgjedhur nje antar i ri per Keshillin Mbikqyres per nje periudhe nga data e kesaj mbledhje.

Z. Roland Hysa- Une propozoj qe Z. Theodhor te zgjidhet per nje mandat tjeter, meqense ka vite qe eshte prane ketij tregu dhe i njeh mire problematikat dhe nevojat qe ka ky treg nga afer dhe mendoj qe qenja e tij ne Keshill do te jete mbeshtetje per shoqerine .

Ka propozime te tjera ? Nuk ka !

Hidhet ne votim , pika e trete e rendit te dites :

Pro 100 % e aksionereve te pranishem!

Kunder asnje.

Miratohet emerimi i Antarit te Ri te Keshillit Mbikqyres Z. Theodhor Kristuli, për një mandat tre vjecar nga 26.04.2019 – 26.04.2022.

Kalohet ne piken e katert te rendit te dites, “ Te ndryshme “.

Z. Valter – Propozoj, duke qene se duam te zhvillojme zonen A5 dhe per te duhet parashikuar pagesa e taksave rreth 2 milion euro, shume e cila eshte e madhe ne kushtet qe shoqeria nuk mund ta paguaj, mendoj qe fitimi i vitit 2018 te kaloje per investim.Pra, propozoj qe fitimi i vitit 2018 te kaloj per Investime.

Ka diskutime te tjera rreth kesaj pike? Nuk ka.

Propozime tjeter ? – Nuk Ka !

Hidhet ne Votim propozimi i Zotit Valter – Te kaloj per Investim Fitimi i Vitit 2018.

Pro 100 % e pjesmarresve

Kunder asnje

Miratohet – Kalimi i fitimit ne Investim!

Autorizohet Drejtoria per ekzekutimin e ketij vendimi.

4. "Te ndryshme"- Pike tjetër është dhe caktimi i eksperteve kontabel për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë "Dinamo Sha" për vitin 2019.

Drejtorja sqaron – Për vitin 2018 kanë qënë 2 ekspertë të miratuar nga Asambleja Znj. Stoli Laze – Shoqëria S&E Laze Audit dhe Z. Ilia Cece. Duke qenë se këta ekspertë kanë disa vite që punojnë si ekspertë të Shoqërisë propozoj që edhe për vitin 2019 të jenë po këto dy ekspertë.
Diskutime ?

Z. Roland është dakort dhe mbështet propozimin për ekspertet Stoli Laze – Shoqëria S&E Laze Audit dhe Z. Ilia Cece.

Diskutime të tjera ?- Nuk ka !

Propozim tjetër – Nuk ka !

Hidhet për votim –

Miratohet njezëri - Ekspertet kontabel të Shoqërisë Dinamo Sha. Për vitin ushtrimor 2019 të jenë Stoli Laze S&E Laze Audit dhe Z. Ilia Cece.

Autorizohet Drejtoria e Shoqërisë të lidhë Kontraten e Shërbimit për vitin 2019 me Shoqërinë S&E Laze Audit dhe Z. Ilia Cece.

Ne përfundim u kalua në marrjen e vendimit si më poshtë, ku Asambleja e Zakonshme e Aksionereve të Shoqërisë "Dinamo" Sha. me pjesëmarrjen e 64.707 % (gjashtëdhjetë e katër e shtatëqind e shtatë %) të aksionereve Asambleja e Aksionmbajtësve,

VENDOSI :

1. Të miratohen treguesit ekonomik-financiar të bilancit të vitit 2018 me fitim të realizuar në shumën 56,076,732 leke.
2. Të miratohet plani i zhvillimit ekonomik të Shoqërisë për vitin 2019.
3. Emerimin në detyrë të Antarit të Ri të Këshillit Mbikqyres të Shoqërisë "Dinamo Sha". Theodor Kristuli. Emerimi fillon nga data 26.04.2019 dhe përfundon me 26.04.2022.
4. Fitimi i vitit 2018 të kalojë për Investime.
5. Të miratohen ekspertet kontabel për auditin e pasqyrave financiare të vitit 2019, shoqëria S&E Laze Audit dhe Z. Ilia Cece.


Të depozitohet ky vendim pranë QKB-se dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore.

Ngarkohet Administratori i Shoqërisë "Dinamo" Sha për zbatimin e këtyre vendimeve.

DREJTUES I MBLEDHJES

SEKRETAR

MIGENA RECI



VALTER JUPI

